



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **21.03.2022** me fillim në ora **15.30**. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSB, përshëndes nënkryetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e dytë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2022 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës.. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19;
3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;
 - Trotuaret, lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese;
 - Qentë endacak;
 - Siguria në trafik;
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla;
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit;
4. Organizimi i takimit publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane;
5. Të ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë e qes në votim. Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia Covid – 19.

Do ju japim një informatë të shkurtër sa i përket gjendjes me pandemi Covid – 19 në komunën tonë, ka rreze të infektuarve sa i përket virusit, në Rahovec kemi vetëm 5 raste aktive. Poashtu ne tani kemi zbutje edhe të masave nga ana e qeverisë qendrore, nuk kemi më orë policore, besoj se kujdesi dhe respekti ndaj vetvetes dhe shëndetit tonë do të vazhdojë tutje për arsye se ende nuk është konstatuar nga asnjë institucion se pandemia Covid – 19 ka përfunduar. Procesi i vaksinimit në komunën tonë ka shkuar shumë mirë, ku me dozën e parë deri më tani janë vaksinuar 24160 persona, me dozën e dytë 16351, gjithsej me dy doza janë vaksinuar 40511 qytetar. Kurse me dozën e tretë janë vaksinuar vetëm 3147 qytetar. Procesi i vaksinimit ende është duke vazhduar me të gjitha dozat, tani nuk ka shumë pritje për të marrë vaksinën në QKMF, tani orari është i rregullt nuk kemi orar të zgjatur. Numri i rasteve me fatalitet të cilët kanë humbur jetën nga infektimi me covid – 19 në komunën tonë është 78 raste, shtabi komunal emergjent është ende aktiv, por nuk ka shumë përgjegjësi sepse këto përgjegjësi tani më shumë janë deleguar Drejtorisë për shëndetësi dhe

përkujdesje sociale. I bëjë thirrje qytetarëve që edhe ata perona që nuk mundën të shkojnë në QKMF për tu vaksinuar ose për të kryer kontroll në e kemi aktiv edhe ekipin mobil dhe ata mundën të shkonë tek ata në shtëpi për të vaksinuar ose për të kryer shërbime mjekësore. Tani fjala është e juaja të nderuar anëtar.

Konkluzion – Lusim qytetarët që të kenë ende kujdes sepse ende jemi në pandemi edhe pse janë zbutur masat, qytetarët të jenë të kujdesshëm në ato vende ku ka qarkullim të madh të njerëzve. Poashtu lusim qytetarët që të vazhdojnë me marrjen e vaksinës, gjithashtu ata që nuk kanë mundësi të lëvizin për arsye të sëmundjeve le të lajmërohen që të shkojë ekipi mobil tek shtëpitë e tyre. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

Sa i përket kësaj pike do i them nga dy fjalë, kurse sa i përket sigurisë fjalën kryesore do e ketë komandanti i policisë në Rahovec. Siguria e përgjithshme në Rahovec vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, nuk kemi ndonjë akses i cili e cenon sigurinë e përgjithshme në komunën tonë. Trotuarët, ne kemi një përpjekje të përbashkët me policinë, inspektoratin dhe shërbimet publike që të lirojmë hapësirat publike që anë të nevojshme për këmbësorë këtë rast flasim për trotuarët, kemi përpjekje që në bazë të një ekspertize e cila do vlerësojë edhe regjimin e ndryshimit të qarkullimit të automjeteve në trafik, fjalën e kamë për ato rrugë të cilat janë të përshtatshme që të jenë rrugë një kaheshe, do të ketë një debat publik ku i presim edhe komentet e qytetarëve, fjalën e kam për rrugën tek shkolla fillore Isa Boletini rruga Xhafer Nurkasa dhe rruga Ibrahim Rugova tek Proper Pica, ku pastaj pretendojmë në këto rrugë të bëjmë edhe shteg për biçikleta. Kemi sfida sa i përket lirim të trotuarëve por ne jemi duke vazhduar me lirim të tyre, mallrat ushqimore më nuk mundën të ekspozohen nëpër trotuare edhe pse kemi disa vështirësi por do ja dalim. Sa i përket qenve endacak nga komuna e Rahovecit llogaritet se janë trajtuar 300 qen në vitin 2021, ky numër e di që është i pamjaftueshëm sepse e di që numri i qeneve endacak është më i madh, jemi në pritje të një lajmi nga MBPZHR ose nga agjensioni i veterinarisë dhe ushqimit, pritet që ata të kenë një plan më të qartë të masave dhe veprimeve kundrejt qenve endacak. Për më shumë fjalën e ka komandanti i policisë.

Fazli Morina, komandanti i policisë - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket situatës së sigurisë gjatë periudhës raportuese ka qenë e qetë dhe stabile. Kurse sa i përket planit operativ për reagim ndaj virusit Covid -19 edhe pse ka zbehje nuk do të thotë që ne e kemi ndaluar planin, por ka një rrënjë shumë të madhe dhe situata është shumë më e qetë. Ne si polici jemi duke i vazhduar punët tona patrullat tona kanë asistuar dhe vazhdojnë të asistojnë Inspektorat Sanitar, AVUK dhe atyre komunal, duke bashkëvepruar sipas kërkesave dhe nevojave në teren. Në kuadër të këtij plani, duke u bazuar në Ligjin NR 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë, patrullat policore të S.P Rahovec gjatë periudhës raportuese, kanë shqiptuar gjithsej: 30 gjoba, prej tyre 17 gjoba për mos vendosjen e maskës mbrojtëse, 12 gjoba për mos respektim të orarit të lëvizjes dhe 1 gjobë për mos mbajtje të distancës. Veprat tjera penale gjatë kësaj periudhe në stacionin policor në Rahovec janë të regjistruara gjithsej 45 vepra penale dhe 3 incidente jo penale, nga këto raste mund të veçojmë disa vepra më të rënda: Vjedhje, 03 raste, vjedhje të rënda, 03 raste, dhunë në familje, 05 raste, armë mbajtje pa leje, 05 raste. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër të stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale në Gjakovë, janë ndërmarr të gjitha veprime e nevojshme. Sa i përket sigurisë në komunikacionin rrugor policia e Kosovës në vazhdimësi ndërmerr masat e nevojshme për ngritjen e sigurisë në komunikacion, për të mundësuar dhe përmirësuar lëvizjen e lirë dhe të sigurtë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor.

Nga S.P Rahovec vazhdon të implementohet P.O “Siguria në trafikun rrugor”, ku në kuadër të këtij plani gjatë periudhës raportuese nga patrullat policore të S.P Rahovec, janë shënuar: Gjoba në Trafik 827, PRQP 0 kundërvajtje. Totali i të gjitha gjobave Covid dhe Trafik 857. Në kuadër të P.O “Lirimi i hapësirave publike nga Automjetet të paregjistruar, të dëmtuara dhe parkingje ilegale” nga SP-Rahovec, janë shënuar: 183 Gjoba për parkingje të pa lejuara në trotuar. Tek siguria në shkolla policia e Kosovës në vazhdimësi është e përkushtuar lidhur me sigurinë e nxënësve, kuadrit arsimor dhe objekteve shkollore, ku gjatë periudhës raportuese, janë bërë vizitat në shkolla dhe kontaktet me kuadrin arsimor, njëkohësisht edhe pika të kontrollit afër shkollave të zonës tone të përgjegjësisë.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të planit vjetor për prezantime në shkolla, hartuar nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim- DPP-Prishtinë, sipas agjendës së planifikimit mujor të S.P Rahovec si dhe nga projekti “Parandalimi i nxitjes për krime të urrejtjes”, janë mbajtur disa aktivitete vetedijesuese

preventive përmes mbajtjes së ligjëratave për nxënësit e klasave prej III-IX, me temat „Bullizmi dhe masat parandaluese“ ‘Siguria e qarkullimit të këmbësoreve në trafik’, dhe “Parandalimi i nxitjes për krime të urrejtjes” ku deri me sot janë përfshirë 14 shkolla fillore të komunës sonë. Këto aktivitete do të zhvillohen në vazhdimësi, për çdo muaj me prezantimin e temave të ndryshme sipas planit vjetor. Sa i përket rasteve në shkolla, gjatë periudhës raportuese, në shkollat e zonës tona të përgjegjësisë, janë raportuar tri raste: 1 rast “Mbajtja e armës së ftohtë” (Brisk) Sh. Fillore “Hamez Thaqi” Xerxe, 1 rast “Dëmtim prone” në SHML Profesionale “Selajdin Mullabazi-Mici”, 1 rast “Lëndim i lehtë trupor” në SHML Profesionale “Selajdin Mullabazi-Mici”. Nëse keni ndonjë pyetje unë jam këtu për të ju përgjigjur.

Lulzim Krasniqi – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket sigurisë në trafik dhe shkollë, kryetar desha të diskutoj sa i përket pikës që e ceket ju për rrugë një kahëshe, kisha propozuar që edhe rruga Gëzim Hamza – Piktori të bëhet rruga një kahëshe sepse në këtë rrugë ka kafiteri, është shkolla pastaj ka ambulanca private dhe gjatë diskutimit me këta banorë ata kanë ankese të mëdha sepse janë duke marrë gjopa për shkak të parkingut, poashtu edhe propozimi i tyre ka qenë që kjo rrugë të bëhet rrugë një kahëshe. Kurse sa i përket sigurisë në shkolla, kam një pyetje për anëtarin e DKA-së, a kanë bërë ndonjë raport sa i përket punës së psikologëve dhe pedagogëve komunal që kanë qenë të angazhuar vitet e kaluara.

Milan Stojanović – Përfaqësuesi i kishës ortodokse Rahovec - Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje sa i përket lagjes së epërme ku banon komuniteti serb, rruga e cila është rregulluar në lagjes e epërme të Rahovecit, nga ai moment janë duke qarkulluar makinat me shpejtësi të madhe, kjo shpejtësi është duke paraqitur rrezik për fëmijët e kësaj lagje sepse fëmijët gjithmonë lozin tek kjo pjesë. Kërkesa jonë është që të bëhet vendosja e pengesave në këtë rrugë në mënyrë që shpejtësia e këtyre makinave të parandalohet edhe pse shumë shpesh policia patrullon në këtë pjesë por më e mira kishte me qenë vendosja e pengesave.

Fazli Morina – Ju faleminderit për pyetjen, e di që ka shumë gjopa tek rruga Gëzim Hamza – Piktori, por për ne në realitet është shumë pak, jo që ne kënaqemi me vënien e gjobave por duke e marrë parasysh situatën në qytet është e pamundur mos shqiptimi i gjobave në mënyrë që ju qytetarët të keni hapësira të lira për të lëvizur, për mendimin time duhet dyfish të jenë gjobat që ne të mbushemi mend një herë e mirë. nga kjo rrugë deri tek parkingu distanca është 200 metra, por ne duam që makinën ta kemi 5m më së largu nga vendi ku dëshirojmë të kryejmë shërbimin.

Konkluzione – Kërkesë për stacionin e policisë në Rahovec që ti shtojë patrullimet, poashtu qytetarët duhet të dinë se policia nuk jep dënime për ata që parkojnë në mënyrë të rregullt makinat. Trotuaret dhe hapësirat publike të vazhdojnë të lirohen, nuk ka kompromise sa i përket kësaj teme. Anëtarët e KKS-së të japin kontributin e vetë në planin e ndërgjegjësimit dhe të vetëdijesimit të qytetarëve për gjërat negative.

Në 11 lokacione që i ka përcaktuar drejtoria e shërbimeve publike janë 373 parkingje, këto parkingje do ja propozojmë kuvendit komunal dhe përmes një ankandi do ja japim ndonjë operatori në shfrytëzim.

Sa i përket pyetjes për DKA-në, besoj në mbledhjen e ardhshme do ta kemi në pikë sa i përket efikasitetit dhe punët e bëra nga ana e psikologëve dhe pedagogëve të angazhuar qoftë edhe me kontrata të përkohshme në shkollat e komunës sonë. Ne jemi të interesuar që ta risim numrin e psikologëve në shkolla që ta risim vetëdijesimin e nxënësve dhe të mos kemi fenomene në shkollat tona sa i përket drogës dhe veprimet që janë të ndaluara me ligje. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Organizimi i takimit publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane.

Kryetari – Për këtë propozim falënderoj përfaqësuesit e OSBE-së, sepse propozimi i tyre ka qenë që kjo pikë të jetë në planin e punës për vitin 2022, kjo vetëm se e ka përforcuar atë që e bëjmë ne në teren. Pas zbutjes së masave anti Covid – 19, besoj se ne do ta shfrytëzojmë maksimalisht kohën për tu takuar me qytetarët tanë, në çdo fshat dhe çdo lagje të qytetit, duke përfshirë edhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, me këta të fundit një takim do ta mbajmë së shpejtë në këtë sallë ku jemi tani. Ne do të kemi takime edhe me grupet e interesit, si me grupin e që së shpejti do të formohet grupi joformal i grave etj.

5. Të ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike, atëherë unë kam një pyetje për komandanti, tiketat që sapo i prezantuat janë shqiptuar para se të lehtësohen masat anti Covid – 19.

Fazli Morina – Të nderuar, tiketat janë shqiptuar kur masat kanë qenë në fuqi, po e ceki edhe një herë nuk është në interesin dhe as në dëshirën tonë që të dënojmë qytetarët, por edhe tani nuk përjashtohet mundësia që të bëjmë shqiptimin e tiketave sepse kemi masa tjera. Tani unë kam një pyetje për ju kryetar dhe mysafirët nga Peja, pra për përfaqësuesit e UNMIK-it, ku ka mbete çështja e vendosjes së kamareve në fshatin Hoçë e Madhe.

Abedin Lataj, Përfaqësuesi i UNMIK-ut – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryetar kërkesa juaj ka shkuar në nivelin qendror është në shqyrtim e sipër, siç kemi biseduar edhe me nënkryetarin, tani duhet ndjekur edhe procedurat që të kalojnë përmes Këshillit të fshatit të Hoçës së Madhe, shpresoj që do të kemi një përgjigje pozitive shumë shpejtë rreth kësaj çështje.

Kryetari – Ju faleminderit, por siç jeni në dijeni këshilli i fshatit Hoçë e Madhe nuk ka mandat për momentin, presim që të formohet sa më shpejtë.

Sabahudin Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj sa i përket një problemi të ndriçimit publik në lagjen ku jetoj unë, i nderuari kryetar ndriçimi publik në lagjen time punon 24 orë, kishte me qenë mirë të shikohet sepse me të vërtetë është gjynah të shpenzohet. Poashtu desha të ju uroj të gjithë besimtarëve islam të ju urojë festën e madhe të Sulltan Nevruzit.

Kryetari – Poashtu edhe unë ja uroj të gjithë besimtarëve festën e Sulltan Nevruzit. Kurse sa i takon ndriçimit publik besoj se drejtori e ka dëgjuar shqetësimin tuaj dhe shumë shpejtë do të intervenoj.

Bujar Morina – Përshëndetje për të gjithë, pyetje ime i drejtohet shefit të zyrës për komunitete sa i përket rastit që ka ndodhur para 2 ose 3 viteve sa i përket, ku janë dëmtuar varrezat e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian. Desha ta pyes shefin a është bërë diçka sa i përket kësaj, a janë riparuar këto varreza edhe pse sipas informatave që i kamë unë ende nuk janë riparuar. Po të ishin varrezat e komunitetit serbë kjo punë moti kishte përfunduar, kur është dëmtuar pllaka në hyrje të fshatit Hoçë e Madhe, ende pa u bërë 24 orë ajo pllakë është rregulluar.

Kryetari – I nderuari Bujar shqetësimi juaj është me vend, por nuk e besoj se kjo është adresa për këtë shqetësim, nëse dëshiron që të maresh përgjigje më të saktë atëherë besoj se z. Lendrit Qeli do ju pres në zyre, poashtu edhe komandanti i policisë, edhe ne jmei të interesuar që të dimë se kush është duke i bërë këto dëmtime edhe pse nuk bëhet vetëm në vendin tonë, këto gjëra bëhen edhe në vendet e tjera.

Lendrit Qeli - Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pyetjes së z. Bujar Morina, ne ende nuk kemi marrë ndonjë informatë me shkrim se ku kanë përfunduar hetimet sa u përket këtij rasti, komuna me kontratën që e ka për rregullimin e varrezave edhe pse një pjesë të këtyre varrezave është rregulluar nga anëtarët e familjes ne tani jemi duke e shikuar mundësin që pjesa e mbetur të rregullohet në ditët në vazhdim.

Kryetari - A ka dikush të shtojë edhe diçka sa i përket kësaj pike, nëse jo atëherë ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoj në ora 16.40

Per 
Procesmbajtësi
Agim Hoti

